

Komuna e Mamushës

Data: 05.09.2019

Mbledhja e 02 e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi

Vendi: Mamushë

PROCESVERBAL

Mbledhja e 02 e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi është mbajtur me datë 05.09.2019 në ora 10:00 në sallën e Asamblesë Komunale.

Nga 13 anëtarë në mbledhje kanë marrë pjesë 11 .

Mbledhja është udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi Z.Abdülhadi Krasniç.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi .

Të nderuar anëtar të Këshillit, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 02 Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Gjendja e sigurisë në Mamushë
3. Diskutimi për sigurinë e shkollës pas hapjes së vitit akademik 2019-2020.
4. 4.Mbrojtja e ambientit
5. 5.Të ndryshme.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

Ë përsëritet të gjithë, mirë se erdhët në mbledhjen e 02 të KKSB-së për vitin 2019. Në këtë është dashur me e shtu pikën shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Rendi i ditës përbëhet nga 5 pika.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

A ka dikush diqka me shtu rreth kësaj pike, nëse jo atëherë votojmë për procesverbal.

Me vota unanime procesverbali u pranua.

A ka dikush diqka me shtu rreth rendit të ditës, këtu është një gabim teknik ku shkruan diskutimi rreth sigurisë në shkolla para hapjes së vitit shkollor .

Kalojmë në pikën e dytë që është

2. Gjendja e sigurisë në Mamushë.

Unë desha me iu dhënë anëtarëve të komisionit disa sqarime. Para disa muajve është shtruar asfalt në komunën e Mamushës dhe pikërisht në atë kohë unë kam shkruar në Turqi dhe kam qëndruar dy ditë. Pikërisht në atë kohë kishte përfunduar asfaltimi dhe ne më herët kemi diskutuar që të vendosim gropat (ose të ngriturat) në rrugë por ndërmarrja e kishte ndërtuar vetëm një gropë (ose të ngriturat) në rrugë tek lagjja e Fetah Ademëve. Ka nevojë edhe për tjera gropat (ose të ngriturat) në rrugë. Ne si komunë kemi

menduar që ta ndërtojme një më të gjatë rreth 3 metra por po kushton shtrejtë. Ne do të shikojmë se si do të jetë me gur këndor. Disa marrin dënime të larta deri 300-500 euro për vozitje pa patentë shoferi, por ata prap vazhdojnë ende të ngasin. Ndoshta edhe komandanti do na jap disa sqarime, urdhëroni.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Ju përshendes të gjithëve, siq e tha edhe kryetari gjendja e sigurisë në Mamushë nuk është keq, krahasuar me të kaluarën ka përmirësimë. Dënimet po vazhdojnë t shqiptohen, vetëm në muajin Gusht janë shqiptuar 69 dënime , 2 raste aksidenti por me lëndime të lehta në njerëz dhe në automjete. Para shkollave po vozisin shumë të rinjë dhe ne me vite të tëra jemi duke ofruar sigurinë e nevojshme. Këtu puna u bie qytetarëve, ata duhet të jenë më të vetëdijshëm, dhënia e makinave fëmijëve është shumë e rrezikshme. Siç thotë edhe kryetari, ka nevojë për gropa (ose të ngriturat) në rrugë sidomos para shkollës. A është me asfalt, gur me qoshe apo me diqka tjetër nuk prish punë por nuk duhet të jetë shumë i lartë sepse po dëmton veturat. Mbrenda një kohe të shkurtër do të instalohen radarët. Vend parkimi me autobus para çajtores është zaptuar nga qytetarët dhe kemi probleme para marketit të madh, nëse keni ndonjë pyetje tjetër urdhëroni.

Cafer Morina:

Ju përshendes të gjithëve, pasi kemi të bëjmë me arsim, them se duhet të merren më shumë masa paraprake në lidhje me trafikun. Disa njerëz ngasin shpejt. Shenjat e trafikut gjithashtu mungojnë aty ku është e nevojshme.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Probleme të tjera janë kabllot e energjisë elektrike dhe postës, të cilat janë të vendosura shumë të ulët dhe në të ardhmen, një kamion mund t'i prishë ato.

Rujdi SHALA:

Kryetar në sa vende mendon ti bësh këto gropa (ose të ngriturat) në rrugë. Është edhe tjetra, rrjedha e qeshmeve në asfalt mund ta dëmtojë këtë asfalt.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

Ne si kuvend nuk kemi ndarë një buxhet për gropa (ose të ngriturat) në rrugë. Ne nuk kujdesemi për kabllot sepse nuk është marrë asnjë leje nga komuna. Këto kabllot janë hedhur më parë nuk kanë parë kurrë kërkesë apo dokument tjetër nga komuna. A ka dikush diqka tjetër me shtu në lidhje me trafik, nëse jo atëherë kalojmë në pikën tjetër.

3. Diskutimi për sigurinë e shkollës pas hapjes së vitit akademik 2019-2020.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

Lidhur me këtë qështje fjalën ia japim drejtorit të DKA-së Z.Cafer Morina.

Cafer Morina:

Ju përshendes të gjithëve, viti akademik 2019 filloi pa asnjë problem dhe ne gjithmonë po themi që siguria në shkollë është shumë e rëndësishme por për të siguruar këtë siguri ne të gjithë duhet ti mbrojmë fëmijët tanë. Sa i përket regjistrimit, ka një rënie në regjistrim në përgjithësi në shkollat e Kosovës, afër 50 regjistrime në shkollë fillore dhe 6-7 nxënës në gjuhën shqipe. Ky numër nuk është përfundimtar sepse regjistrimet akoma po vazhdojnë. Më tepër ka intersim në regjistrim të fëmijëve tek mësimdhënëset e

gjinisë femrore sepse kanë më tepër interesim për fëmijët e tyre. Ekzistojnë afër 50 nxënës në Gjinnaz të regjistruar në drejtimin natyror dhe shoqëror, për momentin nuk kemi ndonjë problem. Ka akoma nevojë për rritjen e sigurisë. Prapa objektit të shkollës fillore është kablloja elektrike e cila duhet të hiqet. Qytetarët hyjnë në shkollë. Detyra më e madhe i takon policisë, ata duhet të patrollojnë më tepër gjatë orarit të pushimeve të shkurtëra të shkollës.

Ajet Sadiku:

A është bërë dezinfektimi në shkollë?

Cafer Morina:

Dezinfektimi bëhet qdo vit.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Si çdo vit tjetër edhe këtë vit kemi përgatitur një plan. Kemi plane për organizimin e seminareve kundër përdorimit të mjeteve narkotike. Ndërsa sa i përket largimit të qytetarëve nga shkolla i keni numrat tanë të telefonit, mundeni me na lajmëru dhe ne intervenojmë menjëherë. Ne vazhdimisht jemi të gatshëm për të ofruar siguri. Në përgjithësi nuk ka ndonjë problem të madhë. Problemi më i madh është vozitja e veturave nga fëmijët por këtu më së shumti duhet të kenë kujdes familjet e tyre.

Cafer Morina:

Ne qdo vit organizojmë seminare të ndryshme rreth trafikut, japim seminare mbi lëndët narkotike dhe lëndëve të tjera.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Cafer abi në lidhje me dezinfektim, intervistoni një kompani dhe në tenderin e hapur duhet të paktën të aplikojnë tri kompani. Nëse është e nevojshme, ne mund të bëjmë dezinfektimin e të gjitha hapësirave publike me atë tender. Përveç kësaj, buxheti i komunës së Mamushës këtë vit është 150 000-200 000 euro më pak. Në këtë rast buxhetin prej 200.000€ për arsim ne kemi biseduar edhe me drejtorët që mësimin ta vëmë në një ndërrim dhe për këtë na duhen klasa shtesë. Ndoshta ky buxhet edhe nuk na mjafton për këtë projekt. Nuk po dijmë ku ta ndërtojmë këtë ndërtesën shtesë, në oborrin e shkollës fillore apo në oborrin e Gjinnazit. Sa i përket sigurisë, Cafer abi merre shënimë që le të hartohet një projekt dhe Lartësia e konstruksionit të rrjetës së telit të jetë 4 metra, si dhe të hapet një kantinë mbrenda shkollës dhe tia mundësojmë nxënësve që mos të dalin jashtë objektit të shkollës gjatë orarit të mësimit. Kemi qenë edhe në Prizren në një shkollë prindi bile me vështirësi munda ta marr fëmijën nga shkolla. Edhe një gjë, Cafer abi thuaj drejtorit të shkollës që të jetë pak më aktiv dhe ti ketë më tepër nën kontroll mësimdhënësit, nëse ka ndonjë problem me nxënësit le të mirret ai vet me ta e jo me thënë ky kordinatori është përgjegjës, jo ai kordinatori është përgjegjës, nëse je drejtor atëherë do ta merr përsipër tërë përgjegjësinë. Nëse thotë që un nuk mund ta barti këtë përgjegjësi atëherë nesër le të jep dorëheqje dhe le të hyjë dikush tjetër në vend të tij. Fajin po na gjuan mua, juve, nëse është drejtor atëherë le ta kryen detyrën e drejtorit, valla nëse thot që nuk po mundem atëherë le të japi dorëheqje. Sa i përket tenderëve Cafer abi ju shikojeni si është gjendja. Por në këtë shkollë është edhe përgjegjësia e menaxhimit, qysh po mirrem unë me tërë Mamushën edhe ai duhet të mirret me shkollë.

Rujdi ŞALA:

Nxënësi prej momentit që hynë në oborrin e shkollës përgjegjësia bie tek mësimdhënësit por nëse ndodh ndonjë problem është shumë normale që edhe ne si prindër jemi përgjegjës. Qëndrimi i të rriturve para shkollës edhe me ligj edhe me fe është e ndaluar.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Pa na ardhur neve ndonjë ankesë nuk mundemi me ndërhy asgjë, me ligj ata kanë drejtë me hec në atë pjesë edhe me qëndru aty.

Cafer MORËNA:

Problemi më i madh është tek prindërit sepse po i thërrasim në mledhje dhe nuk po vijnë, normal edhe mësimsdhënësit kanë përgjegjësi.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Mësimsdhënësit le të vijnë në mëngjes dhe le ti fillojnë mësimet, e jo unë e kam orën e mësimin në ora 10 edhe me ardh në atë orë. Nëse kalojmë në një ndërrim do të kemi edhe përfitime ekonomike.

Rujdi KRÛEZI:

Ju përshendes të gjithëve, unë prej datës 3 të këtij muaji kam filluar detyrën si mësimsdhënësi në Gjimnaz, në këtë rast i falndëroj së pari Kryetarin, drejtorin e DKA-së dhe te gjithëve kolegëve për mundin dhe kontributin e tyre. Sa i përket procedurave të regjistrimit edhe nëse ka regjistrime me vonesë ato janë duke vazhduar akoma.

Cafer MORËNA:

Prap unë dua ta marrë fjalën, më falni që po ua them por unë mendoj që ka me qenë shumë më mirë nëse kalojmë në një ndërrim, në shkollën fillore kemi problem ndërrimi i parë po përfundon mesimin në ora 12 e 30, menjëherë pas tyre po fillon ndërrimi i dytë, po kemi problem me pastërti sepse nuk po mjafton koha për me pastru klasën .

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Unë edhe me juve desha me u konsultu që sa ia vlen me kalu vetëm me një ndërrim edhe a kemi vend në podrum për me bo kantinë. Është shumë e rëndësishme edhe për siguri sepse nuk mundën kaq lehtë të hyjnë të tjerët në shkollë, edhe nga aspekti ekonomik do të kursejmë më tepër. Qëllimi im është që rritet cilësia e mësimin dhe ora mësimore bëhet 45 minuta. A ka dikush diçka me shtu lidhur me arsim , nëse jo atëherë kalojmë në pikën e katërt

4. Mbrojtja e ambientit

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Unë dua të ju jap disa shpjegime lidhur me këtë pikë, në mledhjen e fundit të kuvendi me shumicë votash ka miratuar vendimin për caktimin e lokacionit për hudhjen e mbeturinave të ngurta, ky lokacion është caktuar në pjesën kadastrale mbi objektin zjarrëfiksve. Aty janë bërë disa punime dhe rrugën e kemi bërë të kalueshme deri tek vendi i caktuar por akoma ka disa qytetarë që mbeturinat i hudhin skaj lumit gjë që është e ndaluar. 4-5 herë i kemi pastruar ato vende ku janë hedhur mbeturinat. Prej tash e mas kush hedh mbeturina do të gjobitet. Kemi probleme me kamera, prej ditës që janë vendosur nuk kanë funksionuar të gjitha. Do ta hapim tenderin dhe do ti aktivizojmë. Edhe ju kisha lutur që kush i sheh qytetarët që po hudhin mbeturina fotografojini dhe dërgojini në inspektoriat. Edhe djegia e mbeturinave është e ndaluar edhe nëse është në fushë të vet bile. Zyrtari jonë i iofiqarisë ka dashur ti ndihmojë dikujt dhe tani po thirret në gjykatë. Vitin e kaluar Faik BÛTÛÇ-in e ka dënua komuna e Rahovecit edhe pse i kishte hedhur mbeturinat të arë të vetë. Nëse keni shumë mbeturina merreni veturën edhe dërgojini në deponin në Landovicë. Pa i dënua nuk bëhet zgjidhje në këtë punë.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Këtu puna dhe përgjegjësia më e madhe i takon inspektoriatit të komunës, në anën tjetër qytetarët duhet të njoftohen që pa i gjobitur kjo qështje nuk ndërpritet. Qytetarët duhet të paralajmërohen në mënyra dhe në vende të ndryshme si në shkollë, xhami. Edhe pronarët e bizneseve të ndryshme le të blejnë shporta më të mëdha për mbeturina.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Ne po mendojmë që ta blejmë edhe një makinë për bluarjen e rrënjëve të bimëve në fushë.

Cafer MORINA:

Problemi i mbeturinave është qysh moti dhe për zgjidhjen e këtij problemi duhet të shqiptohen gjoba dhe sa më shpejtë është e mundur të instalohen kamerat e sigurisë. Ne edhe nëse po e shohim ndonjë mik tonin duke hedhur mbeturina po na vie rëndë me lajmëru. Imami i xhamisë vazhdimisht flet për këto por prap nuk ka kurrfarë dobie, më e mira së mirës është që sa më shpejt të aktivizohet sistemi i kamerave të sigurisë.

Rujdi ŞALA:

Na nuk kemi ndërgjegje.

Sedat MORINA:

Heqja e mbeturinave nga fusha jote dhe vendosja në fushën time është një gjest shumë i keq, plus edhe njerëzit po i kallin mbeturinat.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi):

Sa i përket kamerave të sigurimit jemi në përfundim e sipër të hapjes së tenderit. A ka dikush diçka me shtu në lidhje me këtë pikë, nëse jo atëherë kalojmë në të ndryshmet.

5.Të ndryshme :

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Në të ndryshmet unë dua të flas për disa qështje. Sa i përket ndërtimit të ndërtesës së QMF-së është hartuar projekti që e kanë kërkuar Ministria e Shëndetësisë, ky projekt është rreth 1,5 milion, ne po mendojmë që këtë projekt ta shkurtrojmë dhe tia fillojmë punimet sa më shpejtë . Qështja e tjetër ,rruga nga qendra deri tek komuna do të prishet, do të instalohet kanalizimi dhe kabllot nëntoksore, ky është një tender në vlerë 202. 000€. Për projektin për mirëmbajtje parqeve janë ndarë 50, 000€. Një projekt tjetër është edhe renovimi i parkut të Çanakkalesë. Përveq kësaj kanë filluar të hapen rrugët kryesore, për këto po ndihmoni kfori turk. Ne e kemi pasur tenderin por është mbyllur dhe prap po duam ta hapim, një herë është refuzuar. Kfori tani është duke e hapur rrugën e Serapinave, plani jonë është që ta rregullojmë rrugën që shkon në Novakë. Në këtë anë jemi duke e bërë një rrugë në vendin e quajtur Maçovina, përveq kësaj është edhe një rrugë që shkon në Torazhda edhe këtë do ta hapim dhe do ta shtrojmë me guralec. Do ta rregullojmë edhe rrugën Skaçka-Lluka. Këto janë projektet. Këtu është duke u rregulluar edhe një urë dhe në të dy anët kanë me u vendos mure. Tek zjarrfiksat është hapur pusi dhe ka ujë të mjaftueshëm. Prapa objektit të zjarrfikësve jemi duke e ndërtuar një depo sepse pajisjet po jesisin mrapa. Jemi duke bërë disa përmirësime në oborrin e shkollës dhe të gjitha dyert e shkollës do ti ndërrojmë. Pas vënjes së dyerve të reja secili nxënës që do të shkaktojë dëm do ti paguajë babai, kujdestari dhe drejtori i shkollës. Nuk duhet drejtori të postojë fotografi mëngjes dhe mbrëmje, let del pak dhe le të shikon se qka po ndodhë.

Rujdi KRÛEZI:

Unë desha me bë një pyetje rreth punimeve të ujit, ku kanë ngecur ?

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi)

Në Mamushë qe 3 muaj ka ujë por askush nuk po del me kërkuj ujë. Firma pom ban presion mua që kemi shpenzuar 500.000 € para për këtë ujë. Ndoshta ky ujë nuk mundet me qenë uji më i mirë në botë por a ka apo nuk ka ujë është përgjegjësia e ndërmarrjes. Kërkesa e vetme e ndërmarrjes është kyqja e shakteve jashtë oborreve të shtëpisë dhe unë vi ua instaloj ujin.

Sedat MORËNA:

Shtëpia ime është 100 metra larg, qka do të bëhet?

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi)

Të gjithë duhet veq e veq të kyqeni. Shakti i ujit duhet të instalohet jashtë shtëpive.

Sedat MORËNA:

Nëse mua më shihni duke e vjedhur ujin atëherë dënomëni, unë nuk jam kundër kësaj. Ka shumë shpenzime, kushton afër 500 € për me u kyq.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Mamusha ka kërkuar uj, uji ka ardhur, yani obligimi i ka mbetur qytetarëve. Dënimi i keqpërdorimit të ujit është 1000 €. Të nderuar pjesmarrës nëse nuk keni diqka për të shtuar atëherë mledhja e sotme ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
İdriz Mazrek

Kryesuesi i KKSB-së
Abdülhadi Krasniç
